



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 10, datë 17. 07. 2009

PËR
“DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË
NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS DHE INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË”

Në mbështetje të nenit 32, gërma “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); të nenit 6, gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.8487, datë 13.05.1999 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”; VKM-së nr.1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); VKB-së nr.50, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Bashkiake të Tiranës”; VKB nr.51, datë 28.09.2007 për “Ngritjen e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës” dhe VKB-së nr.7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Niveli i pagave i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të VKB nr.50, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Bashkiake të Tiranës”, do të ndryshohet sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2, bashkëngjitur vendimit.
2. Kategorizimi i përgjegjësve të sektorëve në Njësitë Bashkiake me numër banorësh nga 50 001 deri në 100 000 (në III-a/1 apo III-b) përcaktohet nga organet përkatëse vendore.
3. Niveli i pagave i përcaktuar për punonjësit e Njesisë së Menaxhimit të Projekteve (PIU) në pikën 2/i të VKB nr.7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe përdorimin e fondit rezervë” ndryshohet sipas lidhjes nr.12 bashkëngjitur vendimit.

4. Niveli i pagave i përcaktuar për punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në pikën 1 të VKB nr.51, datë 28.09.2007 për “Ngritjen e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranë” ndryshohet sipas lidhjes nr.11, bashkëngjitur vendimit.
5. Paga e grupit për Lidhjet nr.1, nr.5, nr.6, nr.7/1, nr.7/2 në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.7 datë 30.03.2009 bëhet si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	12 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	8 000
3	Diplomë e shkollës 8 - vjeçare	6 000

6. Në pozicionin “**Kujdestare kuzhinierë**” të Lidhjes nr.5 të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.7 datë 30.03.2009, **grupi** bëhet si në tabelë:

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Grupi
8	Kujdestare, kuzhinierë	IV-c/1	1/2/3

7. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Njësitë Bashkiake, Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Qendra Kulturorë “Tirana”, Klubi i Futbollit “Tirana”, Klubi Sportiv “Tirana”, Njësia e Menaxhimit të Projekteve, Aparati i Bashkisë.
8. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 maj të vitit 2009 dhe do të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave në buxhetin e këtij viti.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Bashkiake me 20 001 – 50 000 banorë

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Kryetar i Njësisë Bashkiake	—	—	—	—	90 000
Zv/Kryetar	—	—	—	—	75 000
Sekretar i Këshillit Bashkiak	I	b	12 000	2%	46 000
Përgjegjës Sektori	III	b	12 000	2%	32 500
Përgjegjës Zyre	IV	a	12 000	2%	25 500
Specialist i mesëm	IV	a	12 000	2%	25 500
Specialist i ulët	IV	b	12 000	2%	19 000
Specialist me arsim te mesëm	—	—	—	—	29 000
Sekretar i Kryetarit	—	—	—	—	27 000
Arkivist	—	—	—	—	27 000
Shofer	—	—	—	—	26 000
Punëtor gjelberimi	—	—	—	—	25 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	24 000

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Bashkiake me 50 001-100 000 banorë

EMËRTIMI	Klasa	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Kryetar i Njësisë Bashkiake	—	—	—	—	115 000
Zv/Kryetar	—	—	—	—	90 000
Sekretar i Këshillit Bashkiak	I	b	12 000	2%	57 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	12 000	2%	40 000
Përgjegjës Sektori	III	b	12 000	2%	37 500
Përgjegjës Zyre	IV	a	12 000	2%	26 500
Specialist i mesëm	IV	a	12 000	2%	26 500
Specialist i ulët	IV	b	12 000	2%	23 000
Specialist me arsim te mesem	—	—	—	—	29 000
Sekretar i Kryetarit	—	—	—	—	27 000
Arkivist	—	—	—	—	27 000
Shofer	—	—	—	—	26 000
Punëtor gjelberimi	—	—	—	—	25 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	24 000

Lidhja nr.11

Niveli i pagave për punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik

Nr	Pozicioni	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
1	Kryeinspektor	III-a	1	2%	69 000	15 000
2	Inspektor i larte	III-b	1	2%	52 000	8 000
3	Inspektor i mesem	IV-a	1/2	2%	41 000	3 000
4	Shofer mjetesh teknologjike	IV-c	2/3	2%	18 000	2 000

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 2% **pas çdo viti pune**, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	12 000
2	Diplomë e shkollës së mesme	8 000
3	Diplomë e shkollës 8 - vjeçare	6 000

Lidhja nr.12

Niveli i pagave për punonjësit Njesisë së Menaxhimit të Projekteve (PIU)

Nr	Pozicioni	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
1	Drejtor i projektit	II-a	12 000	2%	105 000
2	Specialist	III-b	12 000	2%	52 000
3	Shofer				30 000

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 2% **pas çdo viti pune**, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grup.